

Rakela LUNIKU

VLERA ETNOGJUHËSORE NË FJALËKRIJIMET E FATOS KONGOLIT, SI MJETI KRYESOR PËR PASURIMIN E MËTEJSHËM TË GJUHËS LETRARE SHQIPE.

Abstrakti: Fatos Kongoli është përfaqësues i denjë i korpusit letrar të shekullit XX në qytetin e Elbasanit. Proza e tij i përket periudhës postkomuniste, me të cilën është bërë i njohur jo vetëm brenda kufijve të Shqipërisë, por edhe jashtë trojeve të saj. Duket sikur Kongoli vazhdoi atë që e la në gjysmë Kadareja, kuptohet në një stil tjetër, pasi përcjell një sistem të trishtë të shoqërisë në versionin letrar. Fitues i disa çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, ai ka marrë titullin e lartë në Francë, "Kalorës i Legjionit të Nderit", akorduar nga presidenti francez, Sarkozy.

Këtë titull e kanë marrë deri tani vetëm tre shqiptarë, Ismail Kadare, Jusuf Vrioni dhe Fatos Kongoli. Punimi evidenton mjeshtërinë e autorit për të përzgjedhur mjetet gjuhësore, aftësitë e tij fjalëkrijuese, të cilat jo vetëm i japin origjinalitet krijimtarisë së tij, por e bëjnë autorin një ndër ndihmësit kryesorë në pasurimin e gjuhës letrare shqipe.

Në korpusin e tij gjuhësor, Fatos Kongoli shpeshherë përdor edhe fjalë thjesht krahinore e dialektore, por duke sjellë rigjallërimin apo shndërrimin e kuptimeve dhe të mjeteve të tyre fjalëformuese. Për rrjedhojë, kemi arritur në përfundimin se krijimtaria gjuhësore e autorit është e shumanshme, por ajo që të bie më lehtë në sy është krijimtaria leksikore, pra, krijimi i fjalëve ose i kuptimeve të reja të fjalëve të njohura, prej nga vjen edhe prurja e madhe leksikore dhe mjetet e shumta fjalëformuese.

Fjalë kyçe: emërtime njëfjalëshe, krijimtari leksikore, leksik potencial, modele fjalëformuese, sintagmë.

Punimi synon të evidentojë njohjen e thellë të autorit ndaj gjuhës, origjinalitetin në përdorimin e saj, si edhe marrëdhënien e tij të ndërsjellë me të.

Dihet që një nga shfaqjet më të rëndësishme të zhvillimit të gjuhës së sotme letrare është padyshim zgjerimi i saj me njësi të reja leksikore e frazeologjike, si edhe i rrethit të kuptimeve të fjalëve të njohura.

Në shqipen e sotme formimi i fjalëve të reja është një proces mjaft i gjallë dhe do të vijojë të jetë burimi kryesor për të përmbushur nevojat e sendeve dhe nocioneve të reja. Gjallërinë e fjalëformimit e dëshmon moria e fjalëkrijimeve në letërsi, të cilat kanë hyrë në përdorim kryesisht pas botimit të FGJSSH, 1980, madje fare pak prurje të reja janë përfshirë edhe në botimin e dytë të "Fjalorit të Shqipes së Sotme", 2002.

Duke gërmuar si një arkeolog i kujdesshëm, në leksikun dhe frazeologjinë e trevës së Elbasanit, Kongoli ka grumbulluar, përpunuar dhe rikrijuar shumë fjalë apo kuptime fjalësh të cilat nuk ekzistojnë në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe.

Në prozën e vjelë nga Kongoli, kemi vënë re disa mjete fjalëformuese mjaft prodhimtare, kryesisht prapashtesa, të cilat kanë interes nga pikëpamja e formimit të fjalëve të reja, si një mënyrë tepër e efektshme për pasurimin dhe rigjallërimin e leksikut të gjuhës shqipe.

Krijimi dhe përdorimi i këtyre fjalëkrijimeve lidhet kryesisht me qëllimet stilistike të autorit.

* Një tip të pasur dhe prodhimtar në prozën e autorit përbëjnë formimet ndajfoljore me prapashtesën **-isht**, kryesisht krijime të përdorura për qëllime stilistike dhe që Jani Thomai i përfshin në stilin libror të ligjërit. Shumica e tyre formohen nga tema emërore me prapashtesat -si, -ri, -im, më rrallë nga tema të tjera:

të lëviznin *vështirësisht*, *anatomikisht*, *dëshpërimisht*, *ngathtësisht*, *paburrërisht*, *mendjelehtësisht*, e kundërshtoi *vendosmërisht*, kishte jetuar *burrërisht*, *pambarimisht*, etj.

Vëmë re që autori parapëlqen më tepër emërtimet njëfjalëshe përkundrejt sintagmave përkatëse me të njëjtin kuptim. mbase kjo është edhe prirja mbizotëruese e autorit, shkurtia gjuhësore (Thomai, 1993).

Ndërsa, FGJSSH parapëlqen variantin emër me parafjalë, p.sh.:

(*me mendjelehtësi*, *me vendosmëri*, *me vështirësi*, *me burrëri*, etj).

* Vazhdojnë emërtimet njëfjalëshe edhe në formimet ndajfoljore me prapashtesën **-shëm**. Kështu, autori përdor ndajfoljen *hapësirshëm* përkundrejt sintagmës (*me hapësirë të madhe*).

Në fakt, produktiviteti i kësaj prapashtese është i njohur kryesisht në formimin e mbiemrave prej emrash, foljesh apo mbiemrash të tjerë. Por, vitet e fundit vihet re një prirje për të përdorur ndërtimet me prapashtesën **-shëm** më tepër si ndajfolje sesa si mbiemra (Thomai, 1993).

Megjithatë, si njësi të veçuara ka raste që mbartin edhe vlera thjesht kuptimore përballë ndajfoljes së thjeshtë, gjë që varet edhe nga kuptimi kategorial i temës fjalëformuese. Me këtë lidhet edhe klasa e mbiemrave me **-shëm**. P.sh:

një zallishtë zbardhte *hapësirshëm* poshtë tij, rënkoj *vuajtshëm* (*me vuajtje*),
donte të shkëputej *përbuzshëm* nga kjo punë, përkundrejt sintagmës (*me përbuzje*),
çdo veprim e kryente *hamendshëm* (*me hamendje*), e vështroi *pikëllueshëm* (*me pikëllim*),
nuk arriti t'i formulojë fjalët *kuptueshëm* (*me kuptim*), fliste gjatë dhe *lodhshëm*,
i lënduar *rëndshëm*, hapat tingëllonin *shkretueshëm* në trotuar, sillej *shkujdesshëm*,
atë gjuhë e fliste *vështirshëm*, sillej aq *përbindshëm*, etj.

Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe në çerdhen fjalëformuese të këtyre fjalëve përmban përkatësisht mbiemrat gjegjës, ndërsa si ndajfolje, shumica e tyre nuk janë të paraqitura.

Ky fakt dëshmon, nga njëra anë, për një prirje të gjuhës standarde drejt sintetizimit duke mos përdorur sintagmat gjegjëse parafjalë + emër, nga ana tjetër, synimin e Kongolit për të përgjithësuar në gjuhën e shkrimit edhe trajta nga gegërishtja, së cilës i përket autori (Demiraj, 1970).

Fakti që ai nuk u drejtohet formave gjegjëse të toskërishtes, d.m.th. mbiemrave prejpjesorë të tipit ecte *menduar*, por formave të gegërishtes me prapashtesën **-shëm**, përkatësisht ecte *mendueshëm* (nga pjesorja geqe *me mendue*), e vërteton më së miri këtë gjë.

Potencialisht të gjithë mbiemrat me *-shëm* mund të kenë ndajfoljet gjegjëse me këtë prapashtesë dhe kjo tregon se leksiku potencial edhe në këtë rast mund të plotësohet fare mirë me njësi dhe tipa fjalëformimi të gegërishtes (Xhuvani, 1949).

Edhe në këtë rast Kongoli e ndien, se stilit të tij të ngjeshur e të shkurtër i shkojnë më për shtat emërtimet njëfjalëshe, në vend të sintagmave gjegjëse me të njëjtin kuptim. Por, kjo nuk na duket vetëm çështje stili, sepse autori sjell risi në gjuhë duke përdorur mjete të reja shprehjeje.

Të tilla janë edhe formimet e mësipërme ndajfoljore me prapashtesën *-shëm*.

Ndonëse në prozën e tij nuk mungojnë edhe formimet mbiemërore me këtë prapashtesë, si:

i llahtarshëm ishte çasti i përmbysjes, zëvendësimi i tyre *i rrufeshëm* me katër shifra, çast *i mrekullishëm*, *i padepërtueshmi* Mark Perjaku, pa arritur të *madhërishmen*, vetëtimin *e paradokohshme*, që më shumë se mësymje ishte një dilemë hamletiane, babëzia *e përbindshme* për t'u pasuruar me çdo mjet, etj.

* Po kështu me prapashtesat *-or*, *-ore*, Kongoli ka sjellë disa modifikime tërësore të krijimeve mbiemërore të formuara kryesisht nga emra (Xhuvani, Çabej, 1962).

imazhin *parajzor*, dëshirë *inatçore*, dykuptimësi *mizore*, hire *fisnikërore*, grafiku i përdorimit *mëngjesor* të banjës, shprehje *kurvërore*, i dha një të kafshuar me po atë stil *krimbzor*, etj.

Një nga parimet kryesore krijuese të Kongolit është kujdesi për formën, prandaj natyrshëm, ai shfaq një kujdes të veçantë në përdorimin dhe përzgjedhjen e mjeteve gjuhësore (Hysa, 1985).

* Në prozën e Kongolit vihet re një përzgjedhje e elementeve gjuhësore dhe shumë kujdes në përdorimin e gjuhës. Ndër këta elementë mund të përmendim gjithashtu disa shprehje frazeologjike tepër të goditura. P.sh:

Kur të shihnin majën e veshit pa pasqyrë :

Siç thuhej në familje, një nga gjyshërit paskej qenë i pasur por, me sa dukej, ne do të mund t'i merrnim kur të shihnim majën e veshit pa pasqyrë.

Në këtë fjali njësia është "*kur të shihnim majën e veshit pa pasqyrë*" dhe është përdorur nga autori me vlerë ndajfoljore, me kuptimin "asnjëherë, kurrë".

Kjo është një nga shprehjet frazeologjike më të bukura dhe më të arrira, të përdorura nga Kongoli, për të treguar "të pamundurën" dhe tingëllon si një përmbledhje idesh e mendimesh që

vjen në fund të fjalisë për të shprehur shpresat e humbura të personazhit.

Si gjalpi në lëkurë të qenit :

Kjo grua e mrekullueshme në rastin tim kishte vajtur dëm si *gjalpi në lëkurë të qenit*.

"E ndjera nëna ime, - thotë autori, për gratë e pafat me burrat e tyre tërë vese, përdorte shpesh shprehjen "ka vajtur si gjalpi në lëkurë të qenit". Sipas saj, një cope lëkure qeni mund t'i hedhësh gjalpë sa të duash, ajo nuk gatuhet, lëkurë se lëkurë mbetet".

Një gjetje e mrekullueshme për gratë e vajtura dëm me burra të padenjë, siç është i padenjë edhe personazhi kryesor për bashkëshorten e tij. I penduar pas vdekjes së saj, ai e quan veten "lëkurë qeni" dhe ky është lajtmotivi i gjithë romanit.

Si një mizë në rrjetën e merimangës :

Njerëzit jetojnë në një botë të pashpirt, në kuptimin e përgjithshëm të fjalës, ndërsa në

kuptimin e ngushtë si një mizë në rrjetën e merimangës.

Autori e ka përdorur këtë njësi për të shpjeguar një situatë që nuk ka shpëtim dhe asnjë rrugëdalje, pra, personazhin e pret një fund i pashmangshëm.

Atë kokërr ulliri nuk e hëngra :

Ta themi midis nesh, unë nuk jam shquar fort për zgjuarsia dhe *atë kokërr ulliri nuk e hëngra*, jo falë ndonjë zgjuarsie, por e shpërfilla atë tension të mallkuar.

Në këtë fjali, njësia është përdorur me vlerë foljore me kuptimin nuk e bëra atë gabim.

Autori ka ndryshuar qëllimisht rendin e fjalëve, sepse në fjalor është “nuk e ha atë kokërr ulliri” por, atij i pëlqen që të bëjë ndryshime edhe te njësia frazeologjike.

Kishte mbetur me gisht në gojë :

Kishte mbetur me gisht në gojë, ndonëse i kishte provuar të gjitha mënyrat.

Në këtë fjali njësia është përdorur me vlerë ndajfoljore, me kuptimin pa gjë, pa rezultat, bosh.

I hipte në kokë një gjë :

Kur Irmës *i hipte në kokë një gjë*, nuk kishte burrë nënë t’ia kthente mendjen.

Në këtë fjali njësia është “i hipte në kokë” dhe përdoret me kuptimin dëshironte.

Këtë shprehje frazeologjike me vlerë foljore autori e ka dhënë enkas për të përcaktuar karakterin e fortë dhe këmbëngulës të një personazhi, si Irma.

T’ia bënte kurrizin më të butë se barkun :

Ai miu halabak ishte kokëkrisur dhe druaj se mund t’ia bënte kurrizin më të butë se barkun.

Në këtë fjali njësia është përdorur me vlerë foljore me kuptimin “e rreh”.

U rrëzua nga fiku :

Për ironi të fatit, ajo *u rrëzua nga fiku për të dytën herë*, kësaj radhe përfundimisht u shpall armike e popullit. Njësi me vlerë foljore me kuptimin, ra nga pozita.

Më ka ardhur në majë të hundës :

Më kanë ardhur në majë të hundës fytyrat tuaja, lustra për të krijuar atë shkëlqim bosh, që trumpetojnë me zhurmë të gjitha kanalet televizive.

Njësia është përdorur me vlerë foljore me kuptimin, më kanë mërëzitur.

Na fiku derën :

Na fiku derën, - u ankua Irma, po tani si do t’ia bëjmë ?

Në këtë fjali njësia është përdorur me vlerë foljore, me kuptimin “na rrënoi”.

Fshati që duket s’do kallauz :

Sa për zotërinë, *fshati që duket s’do kallauz*, Platon, përndryshe ky shtrembërim ka rrezik të përmbajë një të vërtetë.

(Me kuptimin s’ka nevojë për shumë fjalë, gjithçka është e dukshme).

T’i pijë lëngun :

T’i pijë lëngun, - tha njëra nga vajzat kur u mësua kjo hollësi, pa e saktësuar se kush dhe kujt duhet t’i pijë lëngun.

Po kështu kemi evidentuar edhe shumë shprehje frazeologjike interesante:

- Kur meshkujt niseshin *të hidhnin valle në gojë të ujkut* e kanë bërë zakon t’i lënë gratë vetëm në shtëpi e *të çajnë ferrën*.

- Nuk doja *t'i trashja muhabetet* me atë zuskë, *U hodh në sulm* për ta mbrojtur, por më kot,
- *I zhytur deri në grykë* me krimet e tij, etj.

Në fakt në prozën e tij vihen re edhe më shumë njësi frazeologjike, por ne kemi zgjedhur ato njësi që na duken me ngjyrimë më të forta emocionale. Në qoftë se krahasohen me ekuivalentet e tyre kuptimore njëfjalëshe apo disafjalëshe, njësitë frazeologjike të përdorura nga autori janë më shprehëse dhe i përshtaten më mirë kontekstit të caktuar.

Shumë njësi frazeologjike të përdorura nga autori, një pjesë e të cilave gjëllojnë lirisht në leksikun e gjuhës shqipe, në qoftë se u nënshtrohen sistemit të saj fonetik dhe gramatikor, mund të bëhen lehtësisht pronë e gjuhës letrare, duke i sjellë asaj një pasurim të mëtejshëm (Jakobson, 1963).

* Si mjete ngjyruese, autori ka përdorur më së miri disa përemra dëftorë, të cilët mund t'i shtojnë fjalës edhe ngjyrimë emocionale. Këtë funksion ngjyruës emocional të dëftorëve e thekson edhe Benveniste: "... kur nuk janë në fjali për nevoja deiktike, përemrat dëftorë marrin vlerë cilësuese për mirë ose për keq pranë emrave" (Benveniste, 1966).

Që *ajo zuska zeshkane* ia ka marrë shpirtin, kjo është e sigurt.

Kjo shpurë mjeranësh quan burrat, që s'ia dinë vlerën grave.

Barkaliq, ti je si *ai krimbi i pangopur* mollëngrënës.

Qenkam një burracak, një frikaman, përderisa më duhet të ndjek *atë shpurë mjeranësh* dhe të tërhiqem zvarrë nga *ajo dilemë* gjoja *hamletiane*.

Kishte kohë që donte të shpëtonte nga *kjo babëzi e përbindshme*, për t'u pasuruar me çdo mjet. *atë egërsirë* me çrregullime të natyrës skizofrenike.

Siç shihet në fjalitë e mësipërme, përemrat dëftorë nuk tregojnë sende apo frymorë, që ndodhen afër ose larg folësit, por shprehin emocione të ndryshme dhe ajo çka është më e rëndësishme, ata (përemrat dëftorë) edhe mund të mungojnë dhe kjo nuk e cënon aspak kuptimin themelor të fjalës me të cilën shoqërohen.

Shumë shpesh Kongoli përdor disa elemente leksikore që lidhen me thjeshtligjërimit. Mjetet e ligjërimit të shkujdesur gjenden në leksikun që përdorin personazhet. Ironia është përdorur nga autori si një formë kundërvënije, si formë e shprehjes së realitetit objektiv dhe subjektiv, e cila vjen si rrjedhojë e shkallës së lartë të ndërgjegjësimit që kanë arritur personazhet e tij (Lloshi, 1987).

P.sh: gjeli i shtëpisë ia çukit qurrat në hundë; rrufian smirëzi me bark të kërcyer; njeri kokëderr; koka e saj ishte e shëmtuar, si kokë miu; fytyra e dhjamosur dhe gusha e saj të kujtonte fokën; këmbët elefantëshe, etj.

Akoma më e ndjeshme bëhet ironia e përdorur në rastet kur autori e përdor atë jo vetëm për të ironizuar personazhet, por shpesh të bie në sy edhe një ngjyrim i theksuar vetironizues.

Ndërsa unë do të vazhdoj të luaj përjetësisht rolin *e koqes së kandarit*.
Duhet të pranoja statusin *e halabakut*, Unë nuk jam *as karagjoz, as pijanec*,
Qenkam *një burracak, një frikaman*, Jam shumë më tepër *se hipokrit, etj.*

Sigurisht, nuk mund të pretendojmë që çdo fjalë e krijuar dhe e përdorur nga Kongoli mund të hyjë në leksikun e përgjithshëm të gjuhës, sepse dihet që kusht themelor për këtë është, që fjalëkrijimet e reja të ndjekin modelet fjalëformuese të shqipes dhe këtë autori e ka arritur më së miri. Por, për ne ka rëndësi fakti se sa këto fjalë përthithen dhe pranohen nga sistemi leksiko-gramatikor i shqipes.

Bibliografia

- Benveniste, (1966). "Problèmes de linguistique générale", Paris, f. 34-38.
- Demiraj, Sh., (1970). "Rreth ndajfoljërimit të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit parafjalë + emër", Studime Filologjike, nr. 1. f. 65-67.
- Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë, 1980.
- Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë, 2002.
- Hysa, E., (1985). "Dukuri dhe prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare", Gjuha jonë, nr.1. f. 23-26.
- Jakobson, (1963). "Essais de linguistique générale", Paris, f.110-115.
- Lloshi, Xh., (1987). "Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe", Tiranë, f. 98-102.
- Thomai, J., (1989). "Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesën -shëm në gjuhën shqipe", Studime Filologjike, nr. 4. f. 174-182
- Thomai, J., (1993). "Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesën -isht në gjuhën shqipe", Studime Filologjike, 1- 4, f. 324-329.
- Xhuvani, A., Çabej, E., (1962). "Prapashtesat e gjuhës shqipe", Tiranë, f.173-176.
- Xhuvani, A., (1949). "Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqip", Buletini i Institutit të Shkencës, f. 89-94.

Letërsi e konsultuar

- "Lëkura e qenit", 2003.
- "Te porta e Shën Pjetrit", 2005.
- "Jetë në një kuti shkrepësesh", 2007.
- "Bolero në vilën e pleqve", 2008.
- "Iluzione në sirtar", 2010.
- "Si-do-re-la", 2011.